



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT  
13-400/04-39427/27 më 17 MAR 2026

Në bazë të nenit 13, të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110-391, të datës 25.2.2010, si dhe nenit 18 paragrafi 5 të Rregullores nr. 01-011/01-79067/25 dt.04.06.2025, Kryetari i Kryeqytetit nxjerr këtë

### VENDIM

Për shpalljen e thirrjes publike të mbështetjes financiare për qytetarët të cilët janë rezidentë, për përballimin e shpenzimeve të shërimit apo mjekimit sipas kriterëve të përcaktuara në vijim duke mos u kufizuar vetëm në:

- Sëmundjet malinje;
- Sëmundjet të rënda kronike të shoqëruara edhe me çrregullime të sistemeve tjera;
- Sëmundjet, terapia e të cilave nuk janë të përfshira në listë esenciale;
- Terapia pas ndërhyrjeve kirurgjike në kohëzgjatje mbi 12 muaj;
- Lehonat – problemet e shfaqura gjatë kësaj periudhe.

Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike, duke pasur parasysh:

- Numrin e anëtarëve të familjes;
- Çështjen e banimit;
- Koston e trajtimit;
- Gjendjen ekonomike familjare;
- Trajtimin në institucione private vendore ( nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucione publike).

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen nga persona fizike gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve në shëndetësi:

- Dëshmia e diagnozës nga mjeku specialist;
- Dokumenti i identifikimit;
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit, ose nga personi kujdestar ligjor;
- Dëshmi mbi gjendjen ekonomike (se është rast në situatë të vështirë socio - ekonomike);
- Trajtimi në institucione private vendore (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucione publike).



1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik - Subvencione ne lëmin e shëndetësisë;
2. Mbështetja financiare publike, do të ofrohet nga buxheti i Drejtorisë së Shëndetësisë, Kodi ekonomik 22201 - Transferet dhe përfituesit individual tjerë, në kuadër të programit 73350 (Drejtoria e Shëndetësisë),
3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 650,000.00€, prej të cilave:
  - 350,000.00 € grant qeveritar
  - 300,000.00 € të hyra vetanake

Thirrja publike do të publikohen në faqen e internetit dhe ne QSHQ

Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij.

**U dorëzohet:**

- Zyrës për marrëdhënie me publikun,
- Drejtoria e Financave;
- Drejtoria e Shëndetësisë;
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
**Përparim Rama**

